



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

NrProt.

Tiranë, më ____ . ____ . 2017

Lënda: Monitorimi i realizimit të buxhetit të 12- mujorit, për vitin 2016

Drejtuar: MINISTRISË SË FINANCAVE

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 2 datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, po ju paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 12-mujore për vitin 2016.

Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për vitin 2016 i janë akorduar fondet buxhetore, sipas tetë programeve të miratuara për sistemin e bujqësisë dhe të ushqimit, konkretisht:

- ❖ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- ❖ Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit
- ❖ Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes
- ❖ Zhvillimi Rural duke Mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun
- ❖ Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor
- ❖ Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore
- ❖ Mbështetja për Peshkimin
- ❖ Administrimi i Ujrave

Buxheti 12 mujor 2016, i planifikuar për këto 8 programe, është realizuar në masën 97 % ndaj planit vjetor përfundimtar dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Buxheti vjetor fillestar ishte 10.188 milion lekë dhe me shtesat kryesisht si fond i veçantë dhe të tjera rialokime nga Aktet Normative nr. 1 e 2, si vjetor plani përfundimtar është 11.157 milion lekë, miratuar nga Ministria e Financës dhe është realizuar në shumën 10.876 milion lekë.


Gjatë 12 mujorit, realizimet për shpenzime korrente janë 97 %, investimet në total 98 %, nga këto financimi i huaj 100 %, Kosto Lokale 99 %, T.V.Sh 82 % dhe Investimet në objekte 98 % .

I detajuar realizimi 12 mujor sipas programeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri i Programit	Buxheti 2016(mln lekë)	Struktura Në %	Fakti 12 mujor 2016		
				Në mln lekë	Në % ndaj buxh	Struk në %
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	241	2.2	237	98	2.1
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	2.449	21.9	2.363	97	22.6
3	Infrastruktura e Ujitjes, Kullimit	4.448	39.8	4.443	99	40.7
4	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë, Agroindustrinë dhe Marketingun	3.232	28.9	3.104	96	28.5
5	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	201	1.8	185	92	1.6
6	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	25	0.2	24	98	0.2
7	Mbështetja për Peshkimin	363	3.2	362	100	3.2
8	Administrimi i Ujrave	198	2	158	80	1.1
	Totali	11.1578	100	10.876	97	1000

Në realizimin si 12 mujor në nivelin 97 % ndaj planit, peshën më të madhe e zë programi buxhetor “Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit” me 40.7 %, pasuar nga programi “Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë, Agroindustrinë dhe Marketingun” me 28.5 %, programi “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” me 22.6 %, programi buxhetor “Mbështetja për Peshkimin” me 3.2%, programi “Planifikim Menaxhim dhe Administrim” me 2.1 %, programi “Administrimi i Ujrave” me 1.1 %, programi “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor” me 1.6 % dhe programi “Menaxhimi i Tokës Bujqësore” me 0.2 %.

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave për çdo program, sipas PBA-së, buxhetit të 2016 dhe realizimit faktik të 12–mujorit të vitit 2016, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.



Nr	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve, sipas PBA-së 2016	Struktura e shpenzimeve, sipas buxhetit 2016	Struktura e shpenzimeve faktike për 12 – mujorin e vitit 2016
1	Planifikim, Menaxhim,	2.4	2.2	2
	Administrim			
	Siguria Ushqimore dhe	15.	21.	22.6
	Infrastruktura e	40.	39.	40.7
	Zhvillimi Rural duke	33.		28.5
	Këshillimi dhe	2	1.8	1.6
	Menaxhimi i Tokës Bujqësore	0.2	0.2	0.2
	Mbëshetja për Peshkimin	2.2	3.2	3.2
	Administrimi i Ujrave	4	2	1.1
	T O T A L I	100	100	100

Monitorimi i shpenzimeve, sipas programeve

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”

2.

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016 për këtë program, që përfaqëson **rreth 2.6 %** të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 98 përqind
- Shpenzimet kapitale 0 përqind pasi nuk ka të planifikuara.
- **Gjithsej 94 Përqind**

Për vitin 2016, janë parashikuar 4 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi faktik i 12 mujorit 2016		
		Në milione lekë	Në %	Statusi i realizimit
Funksionimi i kapaciteteve, menaxhimi për implementimin e politikave bujqësore	140	138	99	Plotësisht
Ngritja profesionale e stafit	13	12	95	Plotësisht
Menaxhimi i përgjithshëm i institucionit	49	47	96	Plotësisht
Detyrime për anëtarësimin në org. ndërkombëtare	39	38.8	99	Plotësisht
TOTALI	241	236.8	98	

Shpenzimet e këtij programi për paga ndaj planit janë realizuar 99 % dhe shpenzime operative 95 %.

2- Programi “Siguria Ushqimore”

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivalente, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.

Për periudhën 12 mujore të vitit 2016 janë në proces aktivitetet mbi masat profilaktike veterinarë fitosanitare, programi i monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë prej tyre, monitorimi i ujërave e molusqeve bivalente, identifikimi i kafshëve dhe hedhja e të dhënave në sistemin e informacionit blegtoral dhe veterinar Ruda, luftimi i parazitëve në bujqësi dhe mbështetja e të gjithë aktiviteteve të DB-së dhe AKU-së.

Produktet e përfituara për periudhën 12 mujore parashikuar për PBA-në e vitit 2016, të pasqyruar në aneksin bashkëngjitur janë realizuar si më poshtë:

- Ka filluar fushata e vaksinimit të brucelozës të remontit në të imta në bashkëpunim me projektin PAZA “Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike” në masën 690.000 krerë të imta (remont) nga të cilat janë vaksinuar 594.780 krerë.
- Në muajin maj ka filluar programi i monitorimit të mbetjeve në kafshë dhe produkteve me origjinë shtazore si dhe programi i monitorimit të molusqeve dhe ujërave të brendshëm.
- Duke parë situatën aktuale dhe rrezikun e sëmundjeve të shfaqura në shtetet fqinje lindi si domosdoshmëri krijimi i karantinave shtetërore me qëllim rruajtjen e një statusi të lartë shëndetësor të kafshëve si dhe mbrojtjen e shëndetit human. Aplikimi në këtë mënyrë i karantinës nga shërbimi veterinar përbën një risk të

lartë për situatën epizootike që ne po kalojmë, për faktin se në rastet e mbajtjes kafshëve në tipin e karantinës në fermë dhe jo në karantinën shtetërore mund të sjellë shfaqen e sëmundjeve që nuk janë zbuluar dhe shfaqur në vendin e origjinës në kohën e ngarkimit të ngarkesës. Për krijimin e karantinës shtetërore u financua një shumë prej 150 milion lekë.

- Mbështetur në legjislacionin veterinar kombëtar në fuqi si dhe në zbatim të strategjive që rekomandon Evropa në lidhje me masat që duhet të merren për sëmundjen e Dermatozës Nodulare të gjedhit, si dhe nisur nga fakti se kafshët e ngordhura, janë në fermat e vogla ku këto kafshe janë burimi i mbështetjes ekonomike dhe financiare për këto fermerë, si dhe sigurisht prodhimet që përfitohen nga këto kafshe janë burimi dhe baza e sigurimit të produkteve me origjinë shtazore në këto zona. Për sa me sipër zëvendësimi i kafshëve të ngordhura me kafshe të tjera të siguruara nga një nga vendet e Evropës me situatë epizootike të pastër dhe të racave gjenetike me prodhimtari të lartë qumështi dhe mishi është detyrim i kësaj Ministrie. Për kompensimin e kafshëve të ngordhura u blenë kafshë të gjalla të racave me prodhimtari më të lartë me një shumë prej 300 milion lekë.
- Ka filluar fushata e identifikimit të kafshëve të remontit, gjedhë dhe të imta i cili është një proces në vazhdimësi dhe janë matrikulluar 185.258 krerë gjedhë dhe 554.531 krerë të imta. Si pasojë e përhapjes së sëmundjes së LSD në gjedhë në të gjithë territorin e vendit tonë ka lindur nevoja e tejkalimit të planit të matrikullimit pasi janë matrikulluar dhe vaksinuar paralelisht kafshët. Janë vaksinuar 265.000 gjedhë kundra sëmundjes së LSD (Dermatozës Nodulare në gjedhë).
- Janë dëshmshpërblyer një numër prej 145 krerë gjedh dhe të imta kundër sëmundjes së plasjes dhe brucelozës me vlerë prej 24.335 lekë.
- Janë realizuar shpenzimet operative 12 mujore, fondi i pagave dhe sigurimet shoqërore sipas parashikimit në buxhetin 2016 për DB-ve, ISUV dhe AKU.
- Janë realizuar sipas parashikimit shpenzime të investimeve në zërat TVSH dhe kosto lokale, pasi kjo lidhet me zbatimin e projekteve në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, implementimi i të cilave është në proces.

Realizimi i shpenzimeve të 12-mujorit të vitit 2016, për këtë program, që përfaqëson rreth 22.6 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	99	përqind
• Shpenzimet kapitale	94	përqind
• Gjithsej	97	përqind

- ❖ Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore janë realizuar 98 % të fondit vjetor të planifikuar, shpenzimet operative 99 %, ndërsa investimet si realizim financiar paraqiten në 94 %.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi i 12 m të vitit 2016		
		Në milione	Në %	Statusi i realizimit
Legjislacion i përafuar me aktet normative të BE-së	0	0	0	Hequr me buxhetin e rishikuar aktet ligjore realizuar me kapacitetet prog 01110
Kafshë të identifikuar në gjithë vendin - Gjedhë remonti - Të imta	153	151	99%	plotesisht
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në kafshë e produkte prej tyre	33	30	91%	plotesisht
Analiza të kryera, sipas programit për mbetjet në ujëra e molusqe bivalve.	6	6	100%	plotesisht
-Kafshë të Tokës	10	10	100	plotesisht
Të imta të vaksinuara k/ brucelozës (Rev1).	44	40	91	plotesisht
Kafshë gjedhë të gjurmuara për turbekuloz	5	2	40%	pjeserisht
Kafshë gjedhë vaksinuar k/plasjes	1	1	100%	plotesisht
Kafshë gjedhë vaksinuar kundër LSD	60	60	100%	plotesisht
Kafshë të imëta vaksinuar k/plasjes	5	3	0	plotesisht
Kafshe gjedhe te gjurmuara për brucelozë	4	4	0	plotesisht
Kafshë gjedhe të eliminuara si të infektuara nga brucelozja, plasja, tuberkulozi.	500	478	96%	Plotesisht
- brucelozja, plasja, tuberkulozi.	38	29	76%	Plotesisht
- Gjedhë të dëmshpërblyera nga ngordhja nga sëmundja e LSD	300	298	99%	Plotesisht
- Ngritja dhe funksionimi i karantinës shtetërore	150	144	96%	plotesisht
- Financimi I krijimit të Urdhrit të Mjekut Veterinar	12	12	100%	plotesisht
Sipërfaqe e trajtuar k/miut të arave dhe karkalecit, si sëmundje te rënda ne bujqesi, sipas emergjencave	195	190	97%	plotesisht
Inspektim dhe menaxhim i riskut në fushën e sigurisë ushqimore AKU - paga	354	345	97%	plotesisht
- operative	105	96	91%	plotesisht
- investime	0	0		Hequr me AN 2
Analizimi, diagnostikimi dhe referenca për veterinarinë, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit ISUV - paga	84	82	98%	plotesisht
- operative	33	32	99%	plotesisht
- investime	23	23	100%	plotesisht
DB-të në qarqe të plotësuar me kapacitetet e nevojshme funksionale - Paga	358	353	98%	plotesisht

- operative	162	160	99%	plotesisht
- investime	14	11	79%	plotesisht
Projekte në fushën e sigurisë ushqimore	297	277	93%	plotesisht
TOTALI	2.449	2.363	97	

Investimet në total për këtë program janë 486 milion leke, financim i huaj 259 milion lekë dhe 227 milion investim i brendshëm, rezulton realizim financiar si 12- mujor 94 %.

Referuar projekteve të investimeve të huaja si:

- ✓ **Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit, për luftimin e sëmundjeve zoonotike, faza II, IPA 2012 me plan 251 miljon lekë, realizuar 236 milion lekë .**

Projekt i mbyllur si fazë e parë. Një nga arritjet kryesore të Projektit PAZA ka qenë harmonizimi i sistemeve ekzistuese në sektorin e blegtorisë, duke krijuar bazën e të dhënave RUDA. Baza e të dhënave RUDA, përmban të dhëna mbi regjistrin kombëtar të fermave dhe të dhëna të detajuara mbi regjistrimin dhe lëvizjet e gjedhëve dhe të imtat. Sistemi RUDA, përfshin edhe të dhëna vjetore mbi vaksinimet e realizuara dhe matrikullimin e përvitshëm në blegtori. Një nga veprimtaritë më të rëndësishme të realizuara nga projekti ka qenë fushata kombëtare për vaksinimin kundër brucelozës në të imta. Me bashkëfinancimin e ministrisë, është kryer procesi i vaksinimit të bagëtive të imta kundër brucelozës. Realizimi i këtyre objektivave është shoqëruar me një trajnim të strukturave publike dhe të veterinerëve privat që kanë qenë pjesë e fushatave. Faza e dytë është për mbështetjen më vaksina .

3.Programi “Infrastruktura e Kullimit dheUjitjes”

Ky është një nga programet kryesore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, që ofron shërbimin e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, si një nga faktorët e rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor. Rehabilitimi dhe mirembajtja e infrastruktures se ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga permytja, qe realizohet nepermjet programit 04240 ”Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes”, është një ndër prioritetet e qeverisë.

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016, për këtë program, që përfaqëson rreth 41 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 100 përqind
- Shpenzimet kapitale 98 përqind
- **Gjithsej 99 përqind**

- ❖ Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore janë realizuar 100 % të fondit vjetor të planifikuar,

shpenzimet operative 100 % ndërsa investimet si realizim financiar paraqiten në 98 %.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi i 12 m vitit 2016		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes				
Rrjeti i kanaleve kullues i mirëmbajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia)	179	179	100	Totalisht
Rrjeti i kanaleve ujitës i mirembajtur (pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimesia)	57	57	100	Totalisht
Shërbimi i kullimit me ngritje mekanike me hidrovore	298	296	98	Totalisht
Inspektime teknike te infrastruktures se ujitjes, kulimit dhe mbrojtjes nga permbytja ne zonen e sherbimit te ujitjes 360 000 ha dhe zonen e sherbimit te kullimit 280 000 ha perfshi dhe 27 hidrovoret	7	7	100	Totalisht
Rrjete te permiresuara te kanaleve te kullimit	50	48	99	Totalisht
Rrjete te kanaleve ujitese te rehabilituara dhe permiresuara	2640	2640	100	Totalisht
Argjinatura te reja te ndertuara	552	552	100	Totalisht
Argjinatura te rehabilituara	515	515	100	Totalisht
Hidrovore te rikonstruktuar dhe riperstatur	150	149	100	Totalisht
TOTALI	4.735	2.399	99	

Nga shqyrtimi i ecurise se shpenzimeve dhe investimeve te aktiviteteve te produkteve te Programit 04240 "Menaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjes", ne 12 mujorin e vitit 2016 rezulton se:

- Kane perfunduar punimet e mirembajtjes ne infrastrukturen e ujitjes te cilat kane ndikuar ne permiresimin e ujitjes ne rreth rreth 40 000 ha, kryesisht ne ultesiren perendimore Lushnje, Fier, Kavaje, Lezhe dhe Shkoder etj.
- Jane realizuar punimet per pastrimin e rrjetit te kanaleve kryesore kulluese te cilat kane mundesuar permiresimin e kullimit ne rreth 50 000 ha te ultesires perendimore.
- Gjithashtu ne zbatim te vendimit VKM nr. 858, date 7.12.2016, jane realizuar disa nderhyrje emergjente ne mbrojtje nga permbytja ne lumenjte Mat, Drin dhe Bune.
- Ne 27 hidrovore jane instaluar sistemet e monitorimit te sigurise se tyreInvestimet (me financimin e brendshem) per rehabilitimin dhe permiresimin e infrastruktures se ujitjes kane perfunduar si dhe jane kolauduar. Keto investime kane dhene impakt duke permiresuar ujitjen ne skemat kryesore ujitese ne Lezhe (kanali kryesore Mat-Lezhe), Fier (kanali kryesore ujitese Vjose-Levan-Fier), Lushje (3 deget kryesore ujite me rezervuarin e Thanës), Mat (kanali ujitese Klos), Elbasan (kanalet kryesore ujite Naun Panxhi dhe Polis Tudan) me impakt ne rreth 15 000 ha, ku pjese e procesit ne kanalet e dyta dhe te treta tashme jane edhe bashkite.
- Ne lidhje me Projektin e Bankes Boterore, per rehabilitimin e skemave ujitese ne bashkite e Lushnjes, Divjakes, Roskovecit dhe Devollit, aktualisht jane lidhur kontratat per 5 skema ujitese dhe punimet e zbatimit kane filluar

ne muajin dhjetor.

4- Programi “Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor e blegtoral, agroindustrinë dhe marketingun”.

Në programin buxhetor të vitit 2016, programit “Zhvillimi Rural në mbështetje të bujqësisë blegtorisë, agroindustrisë dhe marketingut” ju alokuan gjithsej 3.232 milion lekë dhe përkatësisht:

- Shpenzime korrente	1.944 milion lekë
- Shpenzime kapitale	1.288 milion lekë

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016, për këtë program, që përfaqëson rreth 29 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet korente	96	përqind
• Shpenzimet kapitale	96	përqind
• Gjithsej	96	përqind

Realizimi sipas produkteve:

A. Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë.

Në këtë zë shpenzimesh përfshihen shpenzimet për Buajt, Bagëtitë e Imta, si dhe shpenzimet për Përmirësimin Racor në Gjedh. Gjithësej janë alokuar 8 350 mijë lekë nga të cilat gjatë vitit 2016 janë shpenzuar 7 271.631 mijë lekë ose 87 % e fondit të alokuar. Me VKM nr. 1634 datë 17. 12. 2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve”, si dhe Urdhërit të Ministrisë nr. 84 datë 02. 03. 2008, janë përcaktuar të gjitha procedurat dhe tarifatat për këtë qëllim.

1. Për vitin 2016 u alokuan fonde për buajt prej 3 milion lekë në tre qarqe Elbasan, Lushnje dhe Tiranë. Gjatë këtij viti u mbështetën 2 (dy) ferma (një në Divjakë të Lushnjes me 137 krerë dhe një fermë në Kavajë me 44 krerë) me 181 krerë gjithësej. Ferma e Elbasanit nuk ekziston.

Gjithashtu mbështetur në VKM nr. 1708 datë 29. 12. 2008 “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta” shoqëruar me rregulloren përkatëse nr. 4 datë 18. 08. 2009, të ndryshuar, u alokuan 1.6 milion lekë, për financimin e racave në rrezik zhdukje në Elbasan dhe Shkodër. Nga kjo vlerë janë disbursuar vetëm 1 374 352 lekë ose 86% e fondit të planifikuar. Janë mbështetur rreth 660 krerë (14 ferma) ku 174 krerë janë në Shkodër të racës së vendit dhe 486 krerë në qarkun Elbasan, në Librazhd dhe i përkasin racës Lara e Polisit.

Fondi prej 3.75 milion lekë është alokuar për Përmirësimin Racor të Gjedisit - regjistrimi i treguesve zooteknikë për racat Holshtejn dhe Xhers në DB-të e 5 qarqeve (Durrës, Elbasan, Lushnje, Fier dhe Shkodër). Gjatë vitit 2016 u krye regjistrimi i treguesve zooteknikë përkatës për rreth 2100 krerë në të 5 qarqet e mbështetura (rreth 650 ferma

bërthamë) dhe janë grumbulluar të dhënat për rreth 1890 krerë lopë dhe janë shpenzuar 3 269.119 mijë lekë ose rreth 87.2 % e fondit të alokuar.

B. Promovim i produkteve shqiptare të sektorit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, përmes pjesëmarrjes në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Alokuar 19 000 mijë lekë dhe shpenzuar 18 189. 738 mijë lekë ose 96% e fondit të alokuar. Në mbështetje të objektivave të ministrisë për përmirësimin e infrastrukturës së marketingut dhe nxitjen e biznesit vendas për vitin 2016 janë realizuar 6 (gjashtë) panairë ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe 7 aktivitete promovuese në vend.

C. Mostra të degustuara të duhanit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të konsumatorit.

Ky produkt është realizuar nga Agjensia Kombëtare e Duhan Cigareve. Për vitin 2016 u alokuan 30 096 mijë lekë dhe u përdorën 29 021.961 mijë lekë ose rreth 96.5% e fondit të alokuar. Nga AKDC gjatë këtij viti buxhetor janë degustuar 103 mostra cigaresh për të cilat janë kryer edhe analizat fiziko-kimike dhe nga ana tjetër janë kryer 81 analiza fiziko-kimike për produktet e tjera si duhan i grirë, puro, pureta, cigarillo, etj, pra, në total janë kryer 184 analiza fiziko-kimike.

D. Numër fermerësh burra e gra, përfitues të skemave kombëtare.

Për vitin 2016 për skemat mbështetëse është planifikuar fondi prej 1 522.549 milion lekë.

Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2016 u përdor për:

- a) investimet për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve për të garantuar furnizimin e qëndrueshëm të tregut;
- b) përmirësimin e teknologjisë së kultivimit dhe të mbrojtjes së bimëve;
- c) prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura;
- ç) mbarështimin e blegtorisë, bletarisë dhe akuakulturës;
- d) furnizimin e qëndrueshëm të tregut dhe rritjen e të ardhurave financiare për familjet e zonave rurale;
- dh) nxitjen e kreditimit bankar e të investimeve në sektorin e përpunimit, ruajtjes dhe marketingut të produkteve bujqësore, blegtorale, shpendëve, akuakulturës, mjaltit dhe bimëve medicinale;
- e) rritjen e mundësisë së fermerëve për mjete të mekanizuara;
- ë) nxitjen e formalizimit, kooperimit dhe organizimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

Edhe gjatë vitit 2016 u vazhdua ti jepet përparësi jo mbjelljeve direkte por produktit final. Aktualisht janë kryer 20203 aplikime të cilat janë shqyrtuar nga ana dokumentare dhe janë kualifikuar 11516 aplikantë. Nga ky numër aplikantësh 471 janë gra fermere. Për përfituesit u disbursuan 1 405 168.705 mijë lekë ose 99.8% e fondeve të alokuara.

E. Vrojtime statistikore.

~~Për këtë vit lidhur me vrotimet statistikore janë parashikuar dhe alokuar 3 000 mijë lekë por, dhe u shpenzuan për~~

realizimin e procesit të vrojtimit statistikor 567.480 mijë lekë ose 19% e fondit të alokuar spese procesi i vrojtimit vazhdon në muajt janar dhe shkurt 2017.

F. Fara gruri, misri, patate, perime të tjera, bimë medicinale, etj, të analizuar, testuara dhe certifikuar.

Ky produkt është realizuar përmes Entit Shtetëror të Farnave dhe Fidanëve. Për vitin 2016 për këtë produkt u alokuan 25 617 mijë lekë dhe u shpenzuan 24 354.769 mijë lekë ose 95% e fondit të alokuar. Gjatë vitit 2016 janë analizuar 811 mostra me 3 deri 4 tregues për mostër në funksion të testimeve dhe kontrolleve të fidanëve të ullirit, të pemëve frutore dhe hardhive, si dhe farave të bimëve të arave dhe primeve; gjithashtu, janë certifikuar rreth 20 mijë kv farë dhe rreth 9.9 milion fidana (Fidana pemë frutore 2 500 000 rrënjë; Fidana perimore: 3 400 000 rrënjë; Fidana bimë medicinal: 4 000 000 rrënjë). U krye procesi i testimit për 43 varietetetve dhe hibride (Varietete Misri 13; Grurë 19; Qepujka 2; Patate 2; Duhan 4; Jonxhë 2).

G. Efektivitet i rritur i punës së AZHBR përmes kontrolleve të kryera.

Për këtë produkt janë alokuar 322 186 mijë lekë shpenzime në funksion të kryerjes së kontrolleve në vend nga AZHBR, për të disbursuar mjetet financiare në mbështetje të aplikantëve që synojnë të përfitojnë nga Skemat mbështetëse kombëtare të vitit 2016 (shih produktin D më sipër) dhe janë realizuar 321 129.79 mijë lekë shpenzime ose 99.7 % e fondit të alokuar. Duke kryer kontrollin e 12217 aplikimeve (dosjeve) dhe nga këto rreth 2340 kontrolle në vend, të subjekteve aplikuese të klasifikuara si përfituese.

H. Sipërfaqe vreshti e rregjistruar.

Gjatë vitit 2016 u rregjistruan 4800 njësi vreshti (në kadastrën e vreshtarisë dhe verës) nga QTTB Fushë Krujë. Fondi i alokuar 10 000 mijë lekë dhe i shpenzuar 9 898. 381 mijë lekë ose 99%.

I. Sipërfaqe ulliri e rregjistruar.

Gjatë vitit 2016 u rregjistruan 6032 njësi Ullishte (në kadastrën e Ullirit) nga QTTB Fushë Krujë. Fondi i vënë në dispozicion 10 000 mijë lekë dhe shpenzuar 9 575. 946 mijë lekë ose 96%.

J. Fidanë të prodhuar nga serra mëmë, varietete autoktone.

Alokuar 7 900 mijë lekë dhe realizuar 6 563.123 mijë lekë ose 83% e fondit të alokuar. Janë prodhuar dhe blerë rreth 49500 fidanë.

K. Përmirësim i jetesës në zonat rurale, përmes ndërhyrjes me fonde të donatorëve të huaj.

Për vitin 2016 vazhdojnë të veprojnë një sërë projektesh si: “Fondi i Garancisë për Kreditë Rurale IPA 2012”; “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural - Sared”;

Projekti i biodiversitetit granti Francez; IPA 2013 "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" mbështetje për zonat e përmytura në shkurt të vitit 2015 dhe projekti “IPARD II”

Alokuar 934 993 mijë lekë dhe realizuar si nëntë mujor 529 159 mijë lekë ose 56.6% si vijon:

1. Projekti “Fondi i Garancisë për Kreditë Rurale IPA 2012”

Objektivi - të kontribuojë në fuqizimin e Sektorit Financiar Shqiptar në zonat rurale dhe në përmirësimin e

konkurrueshmërisë së Sektorit Bujqësor në përputhje me objektivat strategjike të procesit të antarësimit në BE. Në lehtësimin e aksesit të fermerëve për kreditë rurale, për të mbuluar një pjesë të kolateralit të tyre pranë bankave apo institucioneve financiare. Alokuar 111 883 mijë lekë dhe realizuar 105 000 mijë lekë ose 94%.

Nga RCGF janë:

- Përgatitur dhe miratuar nga Fondi i Garancisë për Kreditë Rurale, Manuali Operacional dhe Manuali i Investimeve.
- Aprovuar në Bord strategjia e Investimit të Fondeve të RCGF
- Firmosur marrëveshjet e partneritetit me BKT dhe Credins.

2. Projekti “Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural - Sared”

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti synon përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale duke rritur konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe agro-ushqimor nëpërmjet zbatimit të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural. Mbështetja e Qeverisë Daneze dhe Gjermane për dhënie të granteve në Bujqësi në 4 zinxhir vlerash, në 6 rajone të Shqipërisë. Për vitin 2016 janë alokuar 230 400 mijë lekë dhe realizimi 239 683.536 mijë lekë ose 104%.

Janë hapur 3 thirrje të projektit SARED.

Ka përfunduar vlerësimi i thirrjes së parë dhe të dytë. Në proces përfundimi i thirrjes së tretë. Gjatë thirrjes së dytë kanë aplikuar 141 aplikantë në 3 zinxhirë vlerash: bagëti të imta, fruta - arvore dhe bimë mjekësore aromatike dhe janë kontraktuar 134 aplikime.

Po përgatitet hapja e thirrjes së katërt.

Po lançohet i një produkti të ri (paketa kredi) e sjellë në treg nga ProCredit Bank, për përfituesit e projektit SARED.

3. Projekti i biodiversitetit granti Francez.

Janë alokuar 39 000 mijë lekë dhe janë shpenzuar 41 483. 487 mijë lekë ose 106.4 %.

Janë kontraktuar nga projekti tre NGO për zbatimin e aktiviteteve të tre zinxhirëve të vlerës për Mishin e Kecave të Hasit, sherebelës dhe gështenjës në rajonin e Kukësit.

Është kryer inventarizimi i produkteve potenciale për regjistrimin e shenjës së cilësisë.

Ka përfunduar studimi për mishin e kecase të Hasit, gështenjën e tropojës dhe mjaltin e gështenjave si dhe për bimën e borronicës.

4. IPA 2013 "Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" përmbytet.

Alokuar 573 110 mijë lekë dhe janë realizuar 568 791. 340 mijë lekë ose 99.2% e fondit të alokuar.

Aktivitetet e realizuara përmes këtij projekti:

Nënkomponenti 1: Granti i kompensimit:

Procesi i kompensimit ka përfunduar më datë 30. 06. 2016, nga ku rezultoi kompensimi direkt i 3031 fermerë të përmbytur në 5 rajone (Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë) gjatë periudhës Shkurt 2015.

- a. Hartimi i manualit të procedurave për vazhdimësinë e punës për kompensimin e fermerëve;
- b. Me asistencë FAO u hartua Metodologjia për kompensimin e fermerëve;
- c. Janë përgatitur raportet e monitorimit të këtij procesi dhe dërguar pranë EUD.

- d. Janë organizuar 2 takime të Komitetit Drejtues si dhe disa takime në nivel teknik me përfaqësues të EUD dhe MBZHRAU.
- e. është në proces diskutimi kompensimit të 494 fermerëve ende të pakompensuar nga ky grant.

Nën-komponenti II: Granti Investimeve:

- a. është hartuar dhe publikuar Udhësuesi për aplikantet;
- b. është hapur thirrja për këtë grant në 6 rajonet e prekura nga përmbytjet (Lushnje, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë);
- c. është kryer fushata promociionale (spote publicitare, broshura, njoftime në gazeta e radio etj.).

Komponenti 2: Asistencë Teknike:

- Janë kryer trajnime të ndryshme me përfaqësues nga rajonet e prekura nga rreshjet, përfaqësues nga drejtorite teknike në MBZHRAU, etj.

5. IPARD II.

Janë alokuar 200 mijë lekë financim i brendshëm dhe është realizuar 0%. Financimi i huaj - alokuar 0 mijë lekë dhe realizuar 0%. Ky projekt ende nuk ka filluar nga zbatimi.

6. **Bashkefinancim IPA.** Alokuar 82 048. 951 mijë lekë dhe realizuar 34 048.951 mijë lekë ose 41.5%.

L. Fuqizimi i kapaciteteve të MBZHRAU, përmes implementimit të projekteve të huaja që veprojnë në këtë fushë.

Alokuar 465 887 mijë lekë dhe realizuar 227 203.9 mijë lekë ose 48.8% si vijon:

1. Protokollit Italian Programi: Fuqizimi i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor Rural për disbursimin e Granteve në Bujqësi.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është “Fuqizimi i Agjencisë së Pagesave Shqiptare - AZHBR - për lëvrimin e kontributeve në bujqësi”. Synon mbështetje për AZHBR në drejtim të ngritjes së Sistemit të integruar, rregjistrimit të fermerëve, si dhe rregjistrimit të kafshëve, për të krijuar bazat e domosdoshme për akreditim, për përthithjen e fondeve të BE.

Alokuar 23 000 mijë lekë dhe janë shpenzuar 20 714. 859 mijë lekë ose 91%.

Në proces ngritja e infrastrukturës teknologjike dhe paisjeve për AZHBR;

Në proces ngritja e sistemit të identifikimit të parcelave të tokës (LPIS), si dhe rregjistri i fermës. Në proces procedurat e firmosjes së marrëveshjes për asistencën tekniko- ligjore ndërmjet MBZHRAU dhe MIPAAF. Të gjitha procedurat e prokurimit (ARDA 18-26) (ARDA 19) janë dërguar pranë AICS për “No Objection”.

2. Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, IPARD - like I.

Janë alokuar 270 080 mijë lekë dhe realizuar 229 6654.721 mijë lekë ose 85 % e fondit të alokuar. Në proces plotësimi i objektivave për ngritje kapacitetesh për strukturat e ministrisë.

Në kuadër të këtij projekti u mundësua blerja e motorëve për Shërbimin Veterinar, shpërndarë nëpër qarqe.

3. Projektin IPA 2013 “Mbështetje për modernizimin e Sektorit të blegtorisë në Shqipëri”.

Janë alokuar 9 230 mijë lekë, realizimi i investimeve është 4580.612 mijë lekë ose rreth 50%.

~~Janë përgatitur dhe dërguar pranë CFCU, Termat e Referencës për dy kontratat e mëposhtme:~~

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 2, Tiranë
Tel/Fax+4227916

- "Improvement of the performance and quality of the public extension service in the livestock sector", për të cilën është bërë dhe vlerësimi (Asistence Teknike) dhe pritet miratimi nga palët në proces;
- "Design and construction of tëo buildings at ATTC Fushe Kruja and Korca", e cila është në fazën e rishikimit nga CFCU.

4. Protokollin Italian-Projekti pilot për krijimin e eksperimentimit të një sistemi të lehtësuar sigurimesh për mbulimin e rreziqeve në bujqësi.

Janë alokuar 16 950 mijë lekë. Realizimi i investimeve 2016 është 14 809.961 mijë lekë ose 87.4% e fondit të alokuar.

Mbulimi i rreziqeve në bujqësi si një program pilot, domosdoshmëri për fermerët shqiptarë.

Ka filluar puna për një faqe interneti prezantuese e projekteve nën programin PROMAS.

Janë shkëmbyer Nota Verbale mes institucioneve Italo-Shqiptar për amendimin e rialokimit të fondeve për projektin.

Është nënshkruar Marreveshja e bashkëpunimit midis MBZHRAU dhe IGJEUM.

Është përgatitur procedura e 3-të e dosjes së tenderimit për stacionet meteorologjike që do të instalohen në terren.

5. Protokollin Italian -Programi - Për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ullinjve.

Alokuar 31 777 mijë lekë. Realizimi i investimeve 2016 është 13 046. 24 mijë lekë ose 41.1% e fondit të alokuar.

Në proces harmonizimi i legjislacionit të BE-së me atë shqipëtar për sektorin e ullishtarisë.

Fillimi i të gjithë procedurave të tenderimit sipas planit të prokurimit të miratuar nga Komiteti Drejtues.

Ka përfunduar procesi i negociimit CIHEAM-Bari, si organizëm ndërqeveritar.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi 12 mujour 2016		
		Në milion lekë	Në %	Statusi i realizimit
Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë (buajt, të imta, etj).	8.	7	97	plotesisht
Promovimi I produkteve shqiptare të sekt bujq,blegtoral dhe agrop.në panairë komb e ndërkombëtar	19	18	98	plotesisht
Mostra të degustuara të duhanit, në drejtim të ruajtjes së shëndetit të konsumatorit	30	29	99	plotesisht
Numër fermerësh burra e gra përfitues të skemave kombëtare.	1,408	1.405	100	plotesisht
Numër vrojtimesh bujqësore të kryera.	3	3	100	plotesisht
Farëra gruri, misri, patate, perime të tjera, bimë medicinale, etj të analizuar, testuar dhe çertifikuara.	25	24	99	plotesisht
Efektivitet I rritur I punës së AZHBR përmes kontrolleve të kryera.	322	321	100	plotesisht
Sipërfaqe vreshti e regjistruar	10	10	100	plotesisht
Sipërfaqe ulliri e regjistruar	10	10	100	plotesisht
Fidanë të prodhuar nga sera mëmë,sipas varietetve autoktone	8	7	88	plotesisht
Përmirësim I jetesës në zonat rurale, përmes ndërhyrjes me fonde të donatorëve të huaj.	1388	1.272	92	plotesisht
TOTALI	3.232	3.104	96	

5. Programi “ Këshillimi dhe Informacioni bujqësor ”

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016, për këtë program që përfaqëson rreth 2 përqind të totalit të buxhetit fakt të kësaj ministrie dhe sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 92 përqind
- Shpenzimet kapitale 0 përqind (pasi nuk ka investime)
- **Gjithsej 92 përqind**

Në këtë program në kuadër të PBA-së, kanë qenë parashikuar 4 produkte, ecuria e të cilave jepet nga tabela bashkëngjitur.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi i 12 m 2016		
		Në milionë lekë	Në %	Statusi i realizimit
Teknologji dhe paketa teknologjike(elementë të përmirësuar) dhe studime të ofruara	118	110	93%	Plotesisht
Ofrim shërbimesh ekstensionit	50	47	94%	Plotesisht
Të ardhura të realizuara nga QTTB	32	28	88%	Plotesisht
Transferta për buxhetet familjare	0.3	0.3	100%	Plotesisht
TOTALI	201	185	92%	

Në programin “Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor”, përfshihet financimi i aktivitetit të Qendrave të Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Ekstensionit dhe Informacionit Bujqësor, të cilat ndiqen nga sektori përkatës.

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB).

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), gjatë vitit 2016 e kanë përqendruar aktivitetin e tyre në realizimin e detyrave të planifikuara sipas programit të punës të miratuar për vitin 2016.

Produktet e parashikuara të këtij programi janë realizuar si vijon:

Produkti A: Teknologji, paketa teknologjike (elemente të përmirësuar) dhe studime të ofruara. Shpenzimet e planifikuara për këtë produkt, në përfundim të vitit 2016, janë realizuar në masën 93% krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve. Për vitin 2016, ishin planifikuar 15 teknologji/paketa teknologjike (elementë të përmirësuar), si dhe 2 studime në fushën e tokave. Aktivitetet që i shërbejnë *Produktit A* ishin studime, teknika dhe teknologji në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, testime, mirëmbajtje dhe rigjenerime të koleksioneve gjenetike që përdoren për përmirësimin e komponentëve prindëror të farave dhe fidanëve si dhe prodhimine hallkave të larta që u ofrohen fermerëve me çmime konkurruese.

Produkti B: *Ofrim shërbimesh ekstensionit:* Shpenzimet për këtë produkt për vitin 2016 janë realizuar në masën 93%. Aktivitetet që i shërbejnë *Produktit B* janë: 22 kërkime në nivel ferme

që realizohen nga QTTB-të në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit të Ekstensionit në ferma të ndryshme në të gjithë territorin e vendit; trajnime nga QTTB-të, Universiteti Bujqësor dhe Projekte që veprojnë në fushën e bujqësisë në mbështetje të zhvillimit të kapaciteteve për specialistët e Ekstensionit dhe këta të fundit në përmirësimin dhe freskimin e njohurive të fermerëve të interesuar. Nga 140 ditë trajnime të planifikuara për vitin 2016, janë realizuar 161 të tilla. Gjatë këtij viti u përgatitjen e 5 tituj broshurash teknike sipas nevojave të fermerëve nga 7 tituj të planifikuar.

Produkti C: Të ardhura nga QTTB-të të realizuara.

Bazuar në Plan bizneset e QTTB-ve për vitin 2016, realizimi i të ardhurave erdhi kryesisht nga: prodhimi i farërave dhe fidanëve si inpute të gjeneracioneve të larta, nga realizimi i analizave laboratorike të ushqimit, tokës dhe hartografia, si dhe nga shpërndarja e materialit biologjik për përmirësimin racor të gjedhit në vend, etj.

Përdorimi dhe realizimi i të ardhurave nga QTTB-të gjatë vitit 2016, është në masën 86%. Gjatë këtij viti nga QTTB-të, janë realizuar dhe përdorur 27,663 mijë lekë nga 32,200 mijë lekë të planifikuara. Një mungesë në realizimin e të ardhurave ka në QTTB Shkodër ku është realizuar vetëm 75 % prodhimi i farës së misrit hibrid Rozafa 685 në Bazën Eksperimentale, kjo për efekt të mungesës së përputhjes së plotë të fazës së lulëzimit të komponentëve prindërore dhe infeksionit të lartë nga barërat e këqija. Gjatë vitit 2016, QTTB-të kanë kryer shpenzime për punimet bujqësore dhe vënien në punë të hapësirave e aseteve që zotërojnë, si dhe kanë realizuar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, farërave, fidanëve, nga kryerja e analizave laboratorike, hartografia dhe nga shpërndarja e shitja e materialit biologjik, nga shitja e farërave të gjeneracioneve të larta (Super-elitë dhe Elitë) dhe fidanëve të pastër, të sigurtë nga pikëpamja fito-sanitare dhe të kontrolluar e çertifikuar.

Shërbimi i Ekstensionit

Gjatë këtij viti, Strukturat e Ekstensionit (Shërbimit Këshillimor) në qarqe ishin të pranishme dhe zhvilluan aktivitete ekstensionit si demonstrime, ditë fushe, takime të tjera në grup, seminare, panairë, tavolina të rumbullakëta, etj, me synim përmirësimin e shprehive praktike dhe njohuritë e fermerëve.

Nga strukturat e shërbimit Këshillimor u kontaktuan direkt dhe indirekt dhe morën informacion gjithsej 92 000 fermerë dhe agrobiznese, nga 68.000 fermerë dhe agrobiznese të synuara, duke realizuar një tejkalim në fermerët e kontaktuar nga strukturat tona.

Gjatë vitit 2016, u realizuan 161 ditë trajnime të hapura me specialistë të bujqësisë nga 140 ditë të planifikuara si dhe 1 428 ditë trajnime me fermerë të interesuar kryesisht për çështje teknike, ekonomike, të kooperimit, marketingut, për ndryshimet klimatike etj.

Gjatë këtij viti u tenderua shërbimi për të realizuar 19 ditë trajnimi me gra femere, por për arsye të mungesës së ofertave për këtë shërbim, procedura e tenderit nuk u realizua.

U shpërndanë për të interesuarit 34 990 copë fletëpalosje për probleme të ndryshme të teknologjisë në bimë e kafshë, kooperimit bujqësor, menaxhimit të integruar të fermës, etj.

U realizuan gjatë vitit 165 kronika dhe emisione televizive.

7. Programi “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016 për këtë program, që përfaqëson 0.2 % të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 98 përqind
- Shpenzimet kapitale 0 përqind (pasi nuk ka)
- **Gjithsej 98 përqind**

Janë parashikuar për këtë periudhë 2 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2016 në mln	Realizimi i 12 mujorit		
		Në milion	Në %	Statusi
Krijimi Lis/GIS (QTTB)	23.5	23.1	99	Pjesërisht
Dixhitalizim RTB (firma)	1.5	1.4	96	Plotësisht
TOTALI	25	24.5	98%	

Realizimi si 12 mujor është 24. 476 milion lekë ose 98%, sipas objektivave të më poshtme:

Në kuadër të programit “Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore”, në krijimin e Sistemit të Informacionit mbi Tokën (LIS) dhe integrimi në GIS, me një sipërfaqe tokë bujqësore rreth 60 000 ha në njësitë administrative vendore Topojë (fshati Sheq Marinë), Dërmenas (fshatrat Baltëz, Hamil, Muçaj, Radostinë), Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Strum, Ruzhdie, Zharrëz, Roskovec, Mbrostar, Portës, Patos, Kuman, Kurjan të qarkut Fier dhe Kutalli, Poshnje, Perondi, Kozarë, Otlak të qarkut Berat me një fond nga buxheti i shtetit (602) prej 25 milion lekë.

1-Krijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën (LIS) dhe integrimi i saj në GIS

Nga 60 mijë ha tokë bujqësore e planifikuar, kanë përfunduar 61563 mijë ha tokë bujqësore. Nga 23.5 milion leke të planifikuar, janë realizuar si 12 mujor 23.070 milion lekë ose 98%.

2-Dixhitalizimi i Regjistrit të Tokës bujqësore (RTB)

Përsa i përket këtij objekti është realizuar plotësisht në 20 njesi administrative vendore.

Kontrolli dhe marrja në dorrëzim i Regjistrave dixhital për 20 njësi administrative vendore është bërë nga QTTB dhe janë dorëzuar në këto njësi.

Realizimi nga 1.5 milion lekë të planifikuara janë realizuar 1.4 milion lekë ose 93%.

7. Programi “Menaxhimi i Peshkimit”

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016 për këtë program, që përfaqëson 5 përqind të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 100 përqind
- Shpenzimet kapitale 100 përqind
- **Gjithsej 100 përqind**

Janë parashikuar për këtë periudhë 9 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Produkti	Buxheti 2016 në mln lekë	Fakti i 12 mujori vitit 2016		
		Në milionë lekë	Ne %	Statusi i realizimit
Përmirësimi infrastrukturës së Porteve Peshkimit	0	0	0	Nuk ka pasur investime
Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore (Strategjia)	1	1	100%	Plotesisht
Sistemi Blu Box i kontrollit monitorimit të mjeteve peshkimit	20	20	100%	Plotesisht
Kontrollet të ushtruara nga QNOD	8	8	100%	Plotesisht
Rasate të peshkimit të kultivuara në Ohër dhe Prespë	5	5	100%	Plotesisht
Menaxhimi i infrastrukturës së porteve	39	39	100%	Plotesisht
Kontrata dhe leje për peshkim	1	1	100%	Plotesisht
Kontrolle të Inspektoriatit të Peshkimit kundrejt subjekteve të peshkimit të licencuara në peshkim dhe akuakulture	12	12	100%	Plotesisht
Ndërtimi i kapanonit dhe dhomave frigoriferike të Porti të Peshkimit në Durrës	277	277	100%	Plotesisht
TOTALI	363	363	100%	

Realizimi sipas produkteve, të Programit “Mbështetje për peshkim” për vitin 2016 paraqitet si më poshtë:

Produkti A: Përmirësimi i infrastrukturës së Porteve të Peshkimit.

Plani për vitin 2016:	0 mijë lekë	Fakti për vitin 2016:	0 mijë lekë
Plani për vitin i produktit:	0 aktivitete	Fakti për vitin 2016 :	0 aktivitete

~~Produkti B: Akte ligjore dhe nënligjore për burimet peshkore~~

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 2, Tiranë
Tel/Fax+4227916

Plani per vitin 2016: LEK	1000 mijë	Fakti per vitin 2016:	1000 mijë LEK
Plani per vitin i produktit:	5	Fakti per vitin 2016 i produkteve:	5

Produkti C: Sistemi i kontrollit të monitorimit të mjeteve të peshkimit (Blu box):

Plani per vitin 2016:	20000 mijë LEK	Fakti per vitin 2016:	19,518.0 mijë LEK
Plani per vitin i produktit:	1 sistem	Fakti per vitin 2016 :	1 sistem

Ky sistem ka për qëllim të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizmin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Produkti E: Kontrata leje peshkimit

Plani për vitin 2016:	1000 lekë	Fakti për vitin 2016:	1000 mije lekë
Plani per vitin i produktit	350 kontrata	Fakti për vitin 2016 :	350 kontrata

Për të bërë të mundur sigurimin e një shfrytëzimi racional dhe të përgjegjshëm të burimeve biologjike të ujërave të detare dhe atyre të brendshme shqyrtohen kërkesat e ardhura nga subjektet për shqyrtimin e aktivitetit të peshkimit në det dhe në ujërat e brendshme.

Produkti D: Shpenzime për monitorimin e kryera nga nga QNOD.

Plani për vitin 2016:	8000 mijë lekë	Fakti për vitin 2016:	8000 mijë lekë
Plani per vitin i produktit:	1800 kontrolle	Fakti për vitin 2016	1800 kontrolle

Për kryerjen e një procesi sa më të mirë të monitorimit të aktivitetit të peshkimit me qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të burimeve peshkore si dhe për zbatimin e ligjit dhe rregulloreve të sektorit të peshkimit.

Produkti H: Menaxhimi i infrastrukturës.

Plani për vitin 2016:	45.000 mijë lekë	Fakti për vitin 2016	38.732 mijë LEK
Plani për vitin i produktit:	4 porte	Fakti per vitin 2016 :	4 porte

Menaxhimi i porteve është një proces në vazhdimësi për të katër portet e peshkimit: në Durrës, Shëngjin, Vlorë dhe Sarandë.

Produkti I. Rasate të peshkimit të kultivuara në Ekonomitë e Linit dhe të Zvezdës

Plani për vitin 2016:	5,000 mijë lekë	Fakti për vitin 2016:	5,000 mijë lekë
-----------------------	-----------------	-----------------------	-----------------

Plani për vitin i produktit: 500.000 rasate	Fakti për vitin 2016 500.000 rasate
---	-------------------------------------

Produkti J. Kontrolle te inspektoriatit te peshkimit në subjektet e peshkimit te licensuara.

Plani per vitin 2016: 12,000 mijë lekë	Fakti për vitin 2016: 12,000 mijë lekë
Plani për vitin: 1800 kontrolle	Fakti per vitin 2016 1800 kontrolle

Me qëllim zbatimin e Ligjit të Peshkimit Nr.64/2012 dhe në zbatim të Rregulloreve përkatëse për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve peshkore, kryehet procesi i monitorimit dhe kontrollit në lidhje me zbatimin e kushteve të vendosura në lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit si në det dhe në ujërat e brendshme dhe akuakulturë.

Kontrollet e inspektimet janë kryer në bashkëpunim me inspektoriatet e rretheve.

Produkti K. Ndërtimi i kaponit dhe dhomave frigoriferike në Portin e Peshkimit Durrës.

Plani per vitin 2016: 136,920 mijë lekë	Fakti për vitin 2016: 276,796 mijë lekë
Plani për vitin: 1	Fakti per vitin 2016 1

8- Programi :Administrimi i Ujrave

Realizimi i shpenzimeve të 12 mujorit të vitit 2016 për këtë program, që përfaqëson 21 % të realizimit të kësaj ministrie, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 92 përqind
- Shpenzimet kapitale 67 përqind
- **Gjithsej 80 përqind**

Janë parashikuar për këtë periudhë 16 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë.

Prod ukti	Buxheti 2016 në mln lekë	Realizimi i 12m të vitit		Statusi i realizimi
		Në milionë lekë	Në %	
Akte ligjore dhe nenligjore te hartuara dhe	3	3	100	Plotesisht
Raport per gjendjen shtreterve te lumenjve dhe propozimi i masave;	8	8	100	Plotesisht
Raporti financiar per mbledhjen e te ardhurave	5	4.5	92	Plotesisht
Takime mbi marreveshjet me vendet fqinj	3	2.7	95	Plotesisht

Raport vleresimi dhe masash mbi Monitorimin e procedures se paisjes me leje te perdoruesve te burimeve ujore	7	7	100	Plotesisht
Regjistri Kombetar te lejeve te burimeve ujore	1	0	0	Nuk i disburuan fondet
Raport analitik mbi bazen e Monitorimit I demeve te shkaktuar nga hedhja e inerteve ne bregdet dhe zonat turistike	5	5	100	Plotesisht
Raport permbledhese per monitorimin	9	9	100	Plotesisht
Raport vleresimi per verifikimin e kushteve te	8	7.3	96	Plotesisht
Raport monitorimi i ujrave sipërfaqësor dhe nëntokësor	9	9	100	Plotesisht
Inspektime per mbrojtjen e burimeve ujore	1	10	100	Plotesisht
Inspektime per mbrojtjendh e shfrytezimin e inerteve	6	5.5	93	Plotesisht
Inspektime per shkarkimin e ujrave te ndotura	8	7	88	Plotesisht
Strategjia Kombetare per Menaxhimin e Integruar te	3	2	59	Plotesisht
Kadastra e Ujit	58	58	40	Plotesisht
Hartimi I planeve te manaxhimit te baseneve Drin-	20	0	0	Aspak, financiarisht por aktivitet jane ne 90%
TOTALI	198	158	80	

Programi i Administrimit të Ujërave mbështet administrimin e burimeve ujore si një nga burimet natyrore me të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për jetën dhe zhvillimin social-ekonomik të vëndit, për një zhvillim të qëndrueshëm të rezervave ujore, për të kufizuar ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga aktivitetet e veprimtarive industriale, bujqësore dhe aktivitetet e popullsisë në zonat rurale dhe urbane, që shkaktojnë dëmim të ekosistemeve ujore, si dhe të lumenjëve nga shfrytezimi pa kriter i tyre. gjithashtu mbështet bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për administrimin e rezervave ujore, që shtrihet në kufijtë midis vendeve. Ndarja e shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për buxhetin për vitin 2016 është bazuar në;

Përcaktimin e produkteve si prioritete duke synuar në përmirësimin dhe forcimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ujërave sipërfaqësorë, qofshin të përkohshëm apo të përhershëm, të ujërave të brendshme detare, ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore dhe të statusit të tyre, si dhe përafrimi i legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian, Jane miratuar 6 akte nenligjore në zbatim të ligjit 111/2012, pra realizimi i këtij produkti është në masën 60%.

Rehabilitimin e shtretërve të lumenjeve si rezultat i aktivitetit të subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore është realizuar në masën 60%

Evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga hedhja e inerteve në bregdet dhe zonat turistike. është realizuar në masën 80%

Forcimin dhe zbatimin e programit të masave për rehabilitimin e shtretërve të lumenjëve. 50%

Realizimin e të ardhurave nga përdoruesit e burimeve ujore me leje. Raportimi çdo 6-mujor nga

Realizimin e marrveshjeve për ujërat ndërkufitare me vëndet fqinje në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtëme. Janë organizuar takime me vëndet fqinje por akoma nuk është realizuar ndonjë marrveshme për ujrërat ndërkufitare.

Monitorimin e procedurës së paisjes me leje të përdoruesve të burimeve ujore. Me miratimin e akteve nënligjore ka filluar procedura e plotesimit dhe monitorimit të dosjeve të subjekteve për pajisjen me leje të përdoruesve të burimeve ujore

Inspektimin dhe verifikimin e kushteve në lejet e miratuara nga KBU-ja, për përdoruesit e burimeve ujore dhe inerteve lumore, konform legjislacionit në fuqi, marrja e masave për mbrojtjen e tyre 70%.

Inspektimin për evidentimin e të gjithë përdoruesve të burimeve ujore pa leje, evidentimi i të gjithë burimeve ujore nëntokësore (pus-shpime) dhe sipërfaqësore, si dhe për shfrytëzimin pa leje të inerteve lumore. 80%

Bashkëpunimin dhe koordimin e punës me institucionet që përdorin dhe monitorojnë burimet ujore, për një përdorim sa më racional dhe efikas të tyre. 100%

Hartimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit me treguesit e gjendjes, të presionit dhe të ndikimit në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

Monitorimin dhe rakordimin e punës me ABU për implementimin e legjislacionit.

Pregatitjen e Kadastrës së burimeve ujorene masen 90%, Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore 90% dhe pregatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve ujore Drin-Bunë dhe Seman.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VOJO BREGU

Konceptoi, Adriana Nasi

Datë 30.01.2017

Për. Sektori, Entela Kola

Dr. i Financës, Agron Vata